



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 874 / 12 Prot.

Gramsh, më 12.03.2020

V E N D I M

Nr. 24, datë 12.03.2020

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT,
TRANSFERIMIN PËRFUNDIMTAR DHE REGJISTRIMIN
E PASURIVE TË PALUAJTËSHME TË TIPIT PYJE DHE KULLOTA PUBLIKE
NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit "Për rishikimin dhe miratimin e listës përfundimtare të pasurive të tipit "pyje", "kullota" dhe "livadhe", që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Gramsh dhe ndryshimin e VKM-së nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", në mbështetje të:

- Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar);
- Ligjit nr.9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", (i ndryshuar);
- Ligjit nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullor", (i ndryshuar);
- Ligjit nr.8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" (i ndryshuar);
- Ligjit nr.8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", (i ndryshuar);
- VKM-së nr.500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", (i ndryshuar);
- VKM-së nr.360 datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- VKM-ë nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive";

V E N D O S I:

1. Të rishikojë dhe miratojë listën e inventarit për pasuritë "pyje", "kullota" dhe "livadhe", që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Gramsh sipas listës bashkëlidhur.

2. T'i propozojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit fillimin e procedurave për ndryshimin e VKM-së nr.433 datë 08.06.2016, për transferimin në pronësi të Bashkisë Gramsh, të pyjeve dhe kullotave, sipas listës bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Bujqësisë, Mbrojtjes së Konsumatorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

ENDRI MEMA

Konceptoi: E.Mema
Miratoi: G.Lena
Konfirmoi: G.Lena



KRYETARI I KËSHILLIT

GRETA LENA